

KONTRATË
PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË NJË SIPËRFAQEJE PYJORE
E KULLOSORE

E nënshkruar sot më datë 03.05.2013 ndërmjet Kryetarit të njësisë së Qeverisjes Vendore Kthellë, z. Prend Lekgegaj nga njëra anë dhe nga ana tjetër z. Frrok Radaci me cilësinë e përdoruesit të pyllit/kullotës me adresë fshati Perlat Qendër, Komuna Kthellë, rrethi Mirditë.

Mbështetur në:

1. Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë;
2. Ligjin me numër 8652 datë 31.7.2000, i ndryshuar, neni 10, "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore";
3. Ligjin numër 9385 datë 04.05.2005 " neni 23 pika 7 neni 27 pika 10 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor" të ndryshuar;
4. Ligjin Nr. 7916 datë 13.04.1995 "Për livadhet dhe kullotat": te ndryshuar;
5. Ligjin Nr. 7844, datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtëshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore";
6. VKM-në me numër 396 datë 21.6.2006 "Për kriteret e transferimit e të përdorimit të pyjeve nga Njësitë Vendore";
7. VKM Nr. 22, datë 09.01.2008 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kriterëve të administrimit të pyllit komunal", pika 16, 17;
8. VKM me numër 989 datë 0.2.07.2008 "Për dhënien në pronësi të pyjeve dhe kullotave njësisë së qeverisjes vendore";

Palët lidhin këtë kontratë me specifikimet si më poshtë vijon:

OBJEKTI I KONTRATËS

Dhënie në përdorim të një sipërfaqe pyjore prej 4.2 ha në Zonën Kadastrale Nr 2916 me numër pasurie 390, me indeks harte K-34-76-[224-C] me VKM nr. 515, datë 23.04.2008, me të dhënat kadastrale si më poshtë:

Ekonomia pyjore	Emri Popullor	Sipërfaqja (ha)	Nr. Pasurisë	Kufijtë			
				Veri	Lindje	Jug	Perëndim
Perlat Shebë	Rrëza e Shkëmbit, Zabeli Radac	4.2	390	Preng Filei	Perroi Radac	Kojri Fshati	Kojri Fshati

Shënim: Shoqërohet me hartën ku shtrihet kjo sipërfaqe, duke konturuar saktësisht kufijtë dhe kufitarët.

Përshkrimi i pyjeve që merren në përdorim

Ekonomia pyjore	Nr. ngastrës	Sipërfaqja (ha)	Lloji drusor	H _{mes} (m)	D _{mes} (cm)	% e mbulimit
Perlat Shebë	6a	4.2	Qarr	13	14.1	86
			Shparth	13	9.9	14

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE

KOMUNA

Detyrat:

- Të përcaktojë sasinë e materialit drusor dhe të produkteve të tjera pyjore që mund të hiqen çdo vit nga fondi pyjor i marrë në përdorim (sipas planit të mbarështrimit të miratuar);
- Të përfshijë në proces konkurimi dhe të mbështesë me fonde përdoruesin për kryerje punimesh në sipërfaqen pyjore të marrë në përdorim;
- Të asistojë teknikisht përdoruesin për të gjithë problematikën teknike të trajtimit të pyllit të marrë në përdorim;
- Organizon shërbimin e këshillimit dhe ndjek realizimin e objektivave të përcaktuara në Planin e Mbarështrimit;
- I bën të njohur Përdoruesit kriteret për dhënien e investimeve dhe mënyrën e realizimit të punimeve;
- Shqyrton ankimet e Përdoruesit.

Të drejtat:

- Të monitorojë në vijimësi zbatimin e kushteve të kontratës dhe të legjislacionit në fuqi.
- Të prishë në mënyrë të njëanëshme dhe të menjeherëshme kontratën me përdoruesin në rast të shkeljeve ligjore dhe teknike të konstatuara.

MARRËSI NË PËRDORIM

Detyrat:

- Të zbatohet kriteret teknike të parashikuara në planin e menaxhimit të pyllit komunal të pasqyruara në kartelën teknike të parcelës;
- Të marrë përsipër ruajtjen dhe mirëmbajtjen e pyjeve dhe kullotave që merr në përdorim;
- Të mos lejohet kullotjen e gjedhëve kur lartësia e pyllit është nën 3 m, të dhive kur lartësia e pyllit është nën 2 m dhe të dhenve kur lartësia e pyllit është nën 1.5m;
- Në ngastrat e caktuara për krasitje, nga një krasitje për gjeth në tjetrën do të ketë një periudhë pushimi 3 vjeçare. Gjatë krasitjes do të hiqen 2/3 e degeve në pjesën e poshtme të drurit dhe nuk do të dëmtojnë majën;
- Herë pas here do të lerë në pyll drurë me zgavra për të ndihmuar në shtimin e kafshëve dhe shpendëve të egër të pyllit;
- Të zbatohet mënyrat teknike të prerjes të këshilluara në planin e mbarështimit nga specialisti. Të mos bëjë asnjëherë prerje rrafsh me tokën në të gjithë sipërfaqen e marre në përdorim, si dhe shkulje të cungjeve;
- Për të ruajtur pyllin nga dëmtimi i blegtorisë së lagjes të bëjë rrethime me gardhe të thjeshta të pjesëve të pyllit që do t'i jepen në përdorim si dhe të arrijë marrëveshje verbale me kufitarët që nuk do të ketë dëmtime;
- Të përpiqet të heqë vatrën e erozionit duke përdorur mjete rrethore si shmangie të rrjedhjes së ujrave, gardhe, mure të thatë etj.;
- Të paguajë detyrimet që rrjedhin nga përdorimi i pyllit dhe kullotës sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi;
- U përmbahet kriterëve ligjore për përdorimin e investimeve në ngastrat që ka marrë në përdorim.

Të drejtat:

- Të sigurojë material drusor sipas planit të parashikuar;
- Të kullojë bagëtinë dhe të sigurojë material kullosor;
- Të grumbullojë bimë mjekësore dhe prodhime të tjera jo drusore;
- Të konkurojë për të fituar mbështetje financiare në përbërje të Shoqatës së Përdoruesve të Pyjeve e Kullotave, shoqatave dhe organizatave të tjera të njohura ligjërisht, grup familjesh apo dhe i vetëm, si dhe të kryejë vetë dhe me familjen e tij punimet e parashikuara;
- Ka të gjitha të drejtat dhe përfitimet që i jep titulli “në përdorim” i pyllit/kullotës.

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Brenda afatit, kontrata nuk mund të priset në mënyrë të njëanshme nga palët pa shkaqe ligjore e teknike të përcaktuara në këtë kontratë.

Mosmarrëveshjet e mundshme do të zgjidhen me bisedim dhe mirëkuptim të palëve dhe kur kjo nuk arrihet palët i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

VLEFSHMËRIA E KONTRATËS

Kjo kontratë është me afat 10 vjeçar, me të drejtë përsëritje.

Afati i përdorimit të pyllit fillon në datën e nënshkrimit dhe mbaron me datën 30 Janar 2023.

Kontratës i bashkëlidhen dhe janë pjesë e pandarë e saj, këto dokumente:

1. Harta e ngastrës së dhënë në përdorim;
2. Formati i matjeve në terren;
3. Formati i bashkëpërdoruesve;
4. Fotoimazhi i poligonit;
5. Poligoni;
6. Përshkrimi parcelar.

MARRËSI NË PËRDORIM

Frrok RADACI

KRYETARI I KOMUNËS

Prend LEKGEGAJ